



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

**PROJEKTLIGJIPËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIPËRINVESTIMET STRATEGJIKE

Neni 1

Qëllimi

Qëllim kryesor i këtij ligji është nxitja, tërheqja dhe krijimi i lehtësirave për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Kosovë të cilat do të realizohen përmes projekteve, të cilat në bazë të këtij ligji i plotësojnë kriteret për tu konsideruar si projekt strategjik.

Ky ligj poashtu ka për qëllim që të përcaktoj kriteret dhe procedurat për vlerësimin, përzgjedhjen, përgatitjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës të Kosovës për qëllim të implementimit të projekteve për investime strategjike.

Neni 2

Përkufizimet

2.1 Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

2.2. **“Autoritet Publik”** do të thotë cilido organ ekzekutiv qeveritar, ministri, departament, agjenci ose autoritet tjetër që ushtron pushtetin ekzekutiv, legjislativ, rregullativ, administrative-publike në territorin e Republikës së Kosovës.

2.3. **“Investim Strategjik Kategoria A/B”** – është statusi i propozuar nga Komisioni për Investime Strategjike dhe i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili u jepet shoqërive tregtare vendas dhe të huaja, të cilat kërkojnë të realizojnë ndonjë projekt investues, të kualifikuar si strategjik nga ky ligj përgjatë të gjitha fazave të ndërtimit dhe operimit të projektit strategjik në Republikën e Kosovës

2.4 **“Projekti Strategjik”** nënkupton çdo projekt i mundshëm i investimit me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe interes publik, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj për t’u klasifikuar si i tillë.

2.5 **“Prona e Republikës së Kosovës”** do të thotë çdo lloj pasurie e paluajtshme e regjistruar në emër të ndonjë Ndërmarrjeje në pronësi publike ose shoqërore e cila administrohet nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Kosovës apo pasuri e paluajtshme e regjistruar në emër të ndonjë autoriteti ose agjenciepublike të Republikës së Kosovës.

Në kuptim të këtij ligji prona e Republikës së Kosovës mund të jetë e regjistruar në emër të një Ndërmarrjeje në pronësi publike ose shoqërore dhe në emër të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

2.6. **“ndërmarrje shoqërore”** çdo ndërmarrje që Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka në kompetencë për ta administruar në përputhje me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr. 04/L-034).

2.7. “**ndërmarrje publike**” ” nënkupton çdo ndërmarrjet të përcaktuara në listat të cilat i janë bashkangjitur Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Nr. 03/L-087), duke përfshirë ndryshimet në këto lista të cilat bëhen nga Qeveria në përputhje me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.

2.8.“**Agjencia Pyjore e Kosovës**” nënkupton autoritetin publikekzekutiv që është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike në përputhje me Ligjin .

2.9. “**Aktivitet afarist**” çdo aktivitet që përfshinëprodhimin e mallrave, ofrimin e shërbimeve duke përfshirë shërbimet hoteliere dhe turizmin dhe aktivitetet tregtare.

2.10. “**Kontest për njësubjekt investues**” çdo mosmarrëveshje ose pretendim që lind nga një investim i huaj i kryer në bazë të këtij ligji.

2.11 “**Komision**” do të thotë Komisioni për Investime Strategjike, të themeluar me vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës në përputhje me neni 10 të këtij ligji.

2.12 “**Grupi Operacional**” është grupi i cili përbëhet nga ekspertë, të fushave në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik për mbështetur profesionalisht në ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik në përputhje me neni 10 të këtij ligji.

2.13“**ky ligj**” nënkupton këtë ligj dhe të gjitha aktet nën-ligjore dhe instrumentet e nxjerra në bazë të autorizimit të këtij ligji.

Neni 3

Fusha e zbatimit

3.1 Ky ligj zbatohet për të gjitha investimet strategjike, që përzgjidhen si të tilla në bazë të kriterëve e sipas procedurave të përcaktuar në këtë ligj dhe në ata sektorë ekonomikë të përcaktuar shprehimisht nga ky ligj si sektorë strategjike.

3.2. Sektorët strategjikë, në zbatim dh për efekt të këtij ligji konsiderohen:

- a) Sektori energjetik, minerar dhendërtimi i termocentraleve;
- b) Bujqësi dhe industri ushqimore
- c) Turizëm strukturat turistike;
- d) Arsim, teknologjisë, kulturë dhe sport;
- e) Shkencë dhe arsim
- f) Kujdes shëndetësor.

Neni 4

Parimet themelore

Autoritet Publik të Republikës së Kosovë gjatë zbatimit të këtijligj duhet të respektojnë parimin e qarkullimi i lirë e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, parimin e jo diskriminimit, parimin e konkurrencës së lirë parimin e transparencës, si dhe parimin e proporcionalitetit.

Neni 5

Interesi publik

5.1 Investimet strategjike, të përcaktuara si të tilla në këtë ligj, konsiderohen me interes publik. Përcaktimi i interesit publik në përzgjedhjen e një investimi strategjik vlerësohet sipas:

- a) vlerës së investimit;
- b) krijimit të kushteve për hapjen e vendeve të reja të punës;
- c) kohës së realizimit të investimit;
- ç) zhvillimit ekonomik;
- d) zhvillimit apo përmirësimit të kushteve dhe standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve;
- dh) ofrimit të teknologjive të reja për të rritur konkurrencën dhe efektivitetin e investimit;
- e) rritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve;
- ë) mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit.

Neni 6

Kriteret për zgjedhjen e projekteve për investime strategjike

6.1 Në kuptim të këtij ligji projekt për investimestrategjike konsiderohet çdo investim i cili do të krijojëkushte për hapjen e vendeve të reja të punës si dhe do të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë duke ndikuar në përmirësimin e kushteve dhe standardeve të prodhimit të mallrave dhe ofrimit të shërbimeve dhe në përmirësimin e përgjithshëm të kualitetit të jetës së qytetarëve dhe mbrojtjen e ambientit, si dhe do të inkurajojë futjen në përdorim të teknologjive të përparuara të cilat do të ndikojnë në rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit të ekonomisë së Kosovës dhe në uljen e deficitit tregtar dhe do të plotësojë kriteret e parapara me këtë ligj.

6.2 Përveç sa parashikohet në nenin 6 paragrafi 1 të këtij neni, investimet e propozuara për t'u konsideruar strategjike, duhet të përmbushin njëherëshkriteret e përcaktuara si me poshtë:

6.3.1 Për sektorin energjetik, minerardhe ndërtimi i termocentraleve dhe nën sektorëte këtyre fushave investimi duhet të jetë:

(a) i barabartë ose më i madh se 500 000 000 (pesëqind milionë) euro, dhe që në të njëjtën kohë, krijon minimalisht, 700 vende të reja punës, për projektet që do të përfitojnë që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria A”;

(b) i barabartë ose më i madh se 30 000 000 (tridhjetë milionë) dhe që në të njëjtën kohë, krijon minimalisht, 100 vende të reja punës, për projektet që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria B”;

6.3.2 Për sektorin bujqësor dhe industri ushqimoreinvestimi të jetë:

(a) i barabartë ose më i madh se 40 000 000 (katërdhjetë milionë) euro, dhe që në të njëjtën kohë, krijon, minimalisht, 200 vende të reja të punës,për projektet që do të përfitojnë që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria A”;

(b) i barabartë ose më i madh se 4 000 000 (milionë) euro, dhe që në të njëjtën kohë, krijon minimalisht, 40 vende të reja të punës, për projektet që

do të përfitojnë që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria B;

6.3.3 Për sektorin e turizmit apo strukturat turistike investimi të jetë:

(a) i barabartë ose më i madh se 200 000 000 (pesëqind milionë) euro dhe që në të njëjtën kohë, krijon, minimalisht, 500 vende të reja të punës, për projektet që do të përfitojnë që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria A;

(b) i barabartë ose më i madh se 10 000 000 (dhjetë milionë) euro dhe që në të njëjtën kohë, krijon, minimalisht, 30 vende të reja të punës, për projektet që do të përfitojnë që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria B;

6.4 Për sektorin Arsim, teknologji, kulturë dhe sport investimi të jetë i barabartë ose më i madh se 10 000 000 (dhjetë milionë) euro dhe që në të njëjtën kohë, krijon minimalisht, 100 vende të reja të punës, për projektet që do të përfitojnë që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria B.

6.5 Për sektorin zonat kujdesitshëndetësorinvestimi të jetë i barabartë ose më i madh se 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro dhe që në të njëjtën kohë, krijon minimalisht, 200 vende të reja të punës, për projektet që do të përfitojnë që do të përfitojnë statusin “Investim Strategjik Kategoria B.

6.6 Statusin Investim strategjik-Kategoria A, e përfitojnë edhe investitorët/projektet investuese, për të cilat, pavarësisht se nuk janë parashikuar të realizohen në një nga sektorët e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, parashikohet që vlerën totale të kapitalit investues të projektit ta kenë të barabartë ose më të madhe se 100 000 000 (njëqind milionë) euro.

6.7 Projekti i përzgjedhur si strategjik duhet mos të kenë ndikim të lartë negativ ekologjik apo ndikimet negative ekologjike mos të tejkalojnë normat e ndotjes të lejuara me legjislacionin e Kosovës, të mos jetë në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që duhet të plotësohen për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian, si dhe të jetë në përputhje me planet urbanistike të miratuara nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës.

Neni 7

Procedurat për Investimet Strategjike

7.1 Procedurat administrative të parashikuara me këtë ligj të cilat lidhen me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti Investues Strategjike, si dhe me lëshimin e licencave/lejeve autorizuese, në zbatim të këtij ligji kanë prioritet dhe ndiqen me procedurat e përshtetshme të gjitha institucionet dhe autoritetet publike të Republikës së Kosovës të përfshira në këto procedura.

7.2 Të gjitha institucionet dhe autoritetet publike të Republikës së Kosovës detyrohen të bashkëpunojnë dhe t'i japin grupit operacional që ka rolin e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve ndaj investitorit sqarime, informacione dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti strategjik. Roli, përgjegjësitë dhe detyrat në marrëdhëniet e operacional me këto institucione, si dhe rregullat më të hollësishme dhe afatet administrative për procedurat me prioritet të përshtetshme të përcaktuara duhet të rregullohen me aktet nënligjore të këtij ligji.

Neni 8

Aplikacion për Investime Strategjike

8.1 Kërkesa për marrjen e statusit investim strategjik duhet të përmbajë informacionet dhe dokumentet e mëposhtme:

- (a) planin e biznesit të investimit, planin e financimit të investimit dhe programin e punës për realizimin e projektit/investimit strategjik për periudhën 5 vjeçare;
- b) listën me të gjitha kërkesat për mbështetje dhe shërbime që subjekti investues kërkon nga Republika e Kosovës për realizimin e projektit investues;
- (c) vlerësimin e ndikimit social dhe ekonomik të projektit;
- ç) dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues si mënyrë garancie për zbatimin dhe zhvillimin e projektit në fjalë, sipas kërkesave të nenit 6 të këtij ligji;

d) deklarata e subjektit investues të interesuar mbi vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve tëparaqitura në dosje;

dhe) autorizimin me shkrim nga ana investitorin me të cilin autorizohet grupi opercional për marrjen e lejeve/licencave qëllim të realizimit tëprojektit investues strategjik

e) Një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent që dëshmon që ndaj subjekti i investues nuk ka filluar procedura e falimentimit ose nuk është nën administrimin e dhunshëm gjyqësor i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se 30 ditë;

i) dokumenti që vërteton se investitori në vendin ku ushtron veprimtarinë afariste ka përmbushur të gjitha detyrimet tatimore, pensione ve dhe sigurimeve shëndetësore;

Neni 9

Propozimi dhe mbështetja paraprake e një projekti me potencial strategjik

9.1 Subjekti investues i interesuar vendas/i huaj kanë të drejtë për të kërkuar përfshirjen e një projekti investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit “Investim strategjik, Kategoria A ose B.

9.2 Subjekti i investues i interesuar, i cili kërkon përfshirjen në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim të zhvillimit tëprojektit potencial strategjik, duhet të paraqesë njëkërkesë me shkrim pranëgrupit opercional i cila, pasi vlerëson paraprakisht potencialin strategjik tëprojektit, bazuar ne neni 15, të këtij ligjndihmon subjektinpër mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor, administrative të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e investimit.

Neni 10

Procedurat përvlerësimin, përzgjedhjen, përgatitjen dhe zbatimin e projekteve strategjike

10.1 Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim themelon Komisioni për Investime Strategjike (“Komisioni”) si organ për vlerësimin, përzgjedhjen, dhe zbatimin e projekteve për investime strategjike

10.2. Komisioni përbëhet nga:

- a). Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
- b). Ministri i Ekonomisë ;
- c) Ministri i Financave ;
- d) Ministri i Drejtësisë
- d. Kryetari i Komunës në të cilën bëhet investimi i huaj

10.3 Komision ka këto përgjegjësi

- a) Ben vlerësimin e propozimeve për projekt strategjike
- b) Nxjerr vendimin për themelimin e grupit operacional për përgatitjen dhe zbatimin e çdo Projekt Individual për Investime Strategjike dhe emëron kryesuesin e grupit operacional;
- c) monitoron zbatimin e projekteve strategjike;
- ç) miraton planin e veprimet për masat, procedurat dhe afatet në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e një projekti investues strategjik në të cilin përcaktohen veprime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe institucionet lokal për të gjitha fazat e realizimit të projektit;
- d) miraton projektet me statusin “projekt me potencial strategjik”;
- dhe) i propozon Qeverisë vendimin për përfshirjen e tij në listën e projekteve strategjike;

10.4 Qeveria i shqyrton të gjitha rekomandimet e Komisionit dhe mund të refuzojë miratimin e tyre ose t’i ndryshojë ato vetëm me bazë të arsyeshme dhe pas dërgimit të një sqarimi me shkrim mbi arsyet e refuzimit.

10.5 Rolin e Sekretariatit të Komisionit për Investimeve Strategjik e kryen MTI, e cila mundëson të gjithë mbështetjen e nevojshme për organizimin e mbledhjeve të Komisionit.

Neni 11

Grupit operacional për përgatitjen dhe zbatimin e Projekteve mbi Investime Strategjike

11.1 Komisioni emëron anëtarët e Grupit Operacional me profesion jurist, ekonomist, dhe me profesione nga fusha tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të projektit për investime strategjike.

11.2 Grupit Operacional për përgatitjen dhe zbatimin e Projekteve mbi Investime Strategjike ka përgjegjësi për hartimin të vendimit mbi përcaktimin e procedurave dhe përgjegjësi të çdo autoriteti publik të Republikës së Kosovës që merr pjesë në përgatitjen dhe implementimin e një projekti mbi Investime Strategjik

11.3 Drafton vendimet mbi përcaktimin e procedurave dhe përgjegjësi të çdo autoriteti publik të Republikës së Kosovës që merr pjesë në përgatitjen dhe implementimin e një projekti mbi Investime Strategjik, i cili duhet t'i dërgohet Komisionit për aprovim;

11.4 Grupit Operacional ka këto përgjegjësi:

11.4.1 Përcaktimin dhe përshkrimin e detyrave, veprimeve dhe procedurave në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e çdo projekti individual mbi investime strategjike dhe informonin e investitorit të interesuar për to;

11.4.2 kryen veprime që lidhen me paraqitjen e zhvillimit të projektit dhe që mbështesin kryerjen e investimit strategjik dhe hartimin e një liste masash e dokumentesh që duhet të përmbajë dhe/ose duhet të merren për të realizuar projektin e investimit strategjik, përmes proceduarve të përshpejtuara;

11.4.3 bën vlerësimin teknik të projektit të investimit strategjik, të potencialit strategjik të tij, të riskut operacional dhe të planit të veprimit për realizimin e këtij projekti.

11.4.4 bën harmonizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të autoriteve publike për përgatitjen dhe draftimin e dokumenteve të nevojshme për realizimin e projektit dhe të afateve për zbatimin e tyre.

11.4.5 Përcakton përmbajtjen e propozimit të draft vendimit e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi Projekteve Strategjike të cilin vendim duhet t'i dërgohet Komisioni për Investime Strategjike;

11.4.6 Pas regjistrimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për investim Strategjike në Listën e Projekteve Strategjike dhe emërimit të Kryesuesit të Grupit Operacional , Kryesues duhet të përcaktoj autoritet publike përgjegjëse për përgatitjen dhe realizimin e projektit, listën e procedurave administrative të cilat duhet të ndërmerrin dhe veprimeve të nevojshme të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin, të koordinoj punën e anëtarëve të Grupit Operacional pas emërimit të tyre edhe mbikëqyrjen e respektimit dinamikës të kryerjes së punëve të të gjithë pjesëmarrëseve në projekt.

Neni 12
Shqyrtimi i dosjes së projektit me potencial strategjik dhe miratimi i statusit projekt strategjik

12.1 Komisioni për Investime Strategjike, nëpërmjet Grupit Operacional, brenda 30 ditëve pune nga data e paraqitjes së plotë të dosjes së projektit për përfitimin e statusit Investim Strategjik, Kategoria A ose B, verifikon dokumentacionin e depozituar dhe kryen vlerësimin teknik, financiar e strategjik të projektit me potencial strategjik.

12.2 Grupit Operacional në bashkëpunim me grupit operacional, nëse konstaton se dokumentacioni është i paplotë, i kërkon, me shkrim, subjektit investues plotësimin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të kërkuara. Subjekti investues duhet të plotësojë dokumentacionin brenda një afati 30-ditor nga dita e marrjes së njoftimit.

12.3 Nëse projekti strategjik dhe aplikimi i investitorit përmbushin kërkesat e këtij ligji, Grupit Operacional, në bashkëpunim me Komisionin për Investimin

Strategjik, i propozon Qeverisë së Republikës së Kosovës miratimin e statusit Investim strategjik, Kategoria A ose B..

12.4 Qeveria e Republikës së Kosovës në rast se vendos për mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues në Investim/investitor strategjik, kategoria A dhe B”, njofton subjektin investues të interesuar nëpërmjet sekretariatit të Komisionit.

Neni 13

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Përzgjedhjen e Projektit Strategjik

13.1 Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilin aprovohet propozimi i komisionit për dhënien e një projekti si projekt strategjik në përmbajtjen e tij duhet të parashikojë elementet e mëposhtëm:

- a) Titullin e projektit investues investim Strategjike dhe llojin e Kategorisë të projektit ;
- b) Vlerën e parashikuar të kapitalit që do të investohet;
- c) Emrin e investitorit të interesuar dhe partnerëve të tij;
- d) Llojin e projektin investues;
- e) Vendlindjen dhe ku do të zhvillohet ky projekt investues
- f) Arsyetimin për deklarin e projektit si projekt strategjikë rëndësishëm për Republikën e Kosovës i cili duhet të përmbajë një arsyetim më të cilën shpjegohet që projekti i propozuar i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj.

Neni 14

Revokimi i vendimit për dhënien e statusit projekt strategjik

14.1 Në rast se përgjatë përgatitjeve dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komisioni i Investimeve Strategjike merr informata të reja në bazë të të cilave konstaton dhe vërteton sënë projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për **për**

dhënien e këtij projekti statusin e projektit strategjike, Qeveria e revokon vendimin për dhënien e statusit Investim Strategjik për Kategorinë A ose B.

Neni 15

Shërbimet ndaj investitorit pas marrjes së vendimit për dhënies së statusit Investim Strategjik

15.1 Pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit Investim Strategjik Kategoria A ose B, investitori, nëpërmjet Grupit Operacional mund të përfitojë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, shërbime dhe lehtësira të përshkruara në vijim:

- a) procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin kërkesave të cilat ndërlihen me përgatitjen, zbatimin dhe implantimin e projektit strategjik
- d) mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;
- dh) vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjikepa;
- ç) shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;

15.2 Grupi Operacional përcjell kërkesat e subjektit investues që ka përfituar statusin Investim Strategjik, për marrjen e licencave/lejeve/autorizimeve, pranë institucioneve publike, kompetente për lëshimin e këtyre dokumenteve ligjore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

15.3. Institucionet publike, me pranimin ekërkesave nga Grup opercional, brenda 20 ditëve pune, japin licencat/lejet/autorizimet, sipas legjislacionit në fuqi.

15.4. Përyjashtimisht nga sa parashikohet në paragrafin 2 të këtij neni, për shkaqe të arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e licencave/lejeve/autorizimeve, afati shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohe 15 ditë pune.

15.5. Subjekti investues, që ka përfituar statusin Investim Strategjik, ka përgjegjësinë për plotësimin me korrektësi dhe vërtetësi të të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme për lëshimin e licencave/lejeve/autorizimeve përkatëse në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Neni 16

Marrëveshja mbi Përgatitjen dhe Realizimin e Projekti Strategjik me subjektin e interesuar

16.1 Marrëveshja për realizimin e Projekteve Strategjik me subjektin e interesuar lidhet në mes se Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe investitorin të interesuar brenda 30 ditëve hyrës në fuqi të vendimit mbi Investimet Strategjike të

16.2 Marrëveshja për realizimin e Projekteve Strategjik, përpos elementeve të përcaktuar me legjislacion e aplikueshëm dhe vendimine Qeverisë së Republikës së Kosovës për përzgjedhjen e një Projekti si Projekt Strategjik, në përmbajtjen e tij duhet të parashikojë zotimet e marra përsipër nga Republika e Kosovës dhe investitori për qëllim për zbatimin të projektit Strategjik Investues, afateve për përmbushjen e obligimeve të marra perisperi për secilën palë, afatet e përmbushjes së çdo obligim, mekanizma për të mbrojtur interesat e Republikës së Kosovës në rast të tejkalimit të afateve, apo braktisjen se realizimit të tyre. ë

Neni 17

Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike

17.1 Në dispozicion të zhvillimit dhe realizimit të projekteve strategjike, sipas këtij ligji, mund të vihen pyjet, toka bujqësore, si dhe pasuritë tjera tëpaluajtshme në pronësi shoqërore, publike dhe komunale të cilat janë pronë e Republikës së Kosovës..

17.2 Mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme nëpronësi të Republikës së Kosovës për zhvillimin dhe realizimin e projekteve Investuese Rstrategjike rregullohet me akte nënligjor të cilin e harton MTI dhe i aprovona Qeveria e Republikës së Kosovës.

17.3 Prona e Republikës së Kosovës e nevojshme për realizimin e projekteve për Investimet Strategjike do t'i bartët në shfrytëzim investitorit të interesuar pa ju nënshtruar procedurave të prokurimit dhe tenderimit publik të parapara me ligjet e Kosovës sipas çmimit të tregut në pajtim me vlerësim e bërë nga eksperti i autorizuar.

17.4 Vlera e tregut të pronës së Republikës së Kosovës përcaktohet duke marr për bazë çmimet e privatizimeve të bërë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në komunën në të cilën do të realizohet projekti mbi investim strategjike.

Neni 18

Shpronësimet për interes publik

18.1 Për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, të cilat kanë përfituar statusin Investim Strategjik, në zbatim të këtij ligji, si dhe të punëve dhe shërbimeve mbështetëse infrastrukturore, lejohet shpronësimi, për interes publik, i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, sipas rregullimeve në legjislacionin e aplikueshëm për shpronësimin për interes publik, nëse investitori nuk ka mundur ta zgjidhë pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme me marrëveshje me pronarin e pasurisë së paluajtshme.

18.2. Shpronësimi, për interes publik, i pasurive të paluajtshme, pronë private, realizohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për shpronësimet për interes publik.

18.3 Shpronësimi, për interes publik, i pasurive të paluajtshme, pronë private, në zbatim të këtij ligji, nuk lejohet për shpronësimin e pasurive të paluajtshme në pronësi të investitorëve strategjikë të tjerë dhe investitorëve të huaj.

Neni

19

Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike

19.1. Në funksion të mbështetjes shtetërore për realizimin e investimit, krijohet Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, i cili krijohet nga pasuritë e paluajtshme shtetërore, në pronësi të institucioneve qendrore apo të njësive të qeverisjes vendore.

Neni 20

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjes shoqërore tek investitori i interesuar

20.1 Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një ndërmarrjeje shoqërore apo ndonjë pronë të saj që është nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit tek investitori i interesuar, vetëm pasi që Kuvendi i Kosovës në bazë të propozimit të Qeverisë të marrë vendim për heqjen e ndërmarrjes shoqërore apo pronës së saj nga autoriteti administrativ i Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe t'i bartë atë pronë Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike

20.2 Nëse Kuvendi i Kosovës merr një vendim për heqjen e ndërmarrjes shoqërore apo pronës së saj nga autoriteti administrativ i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, atëherë prona e tillë fillimisht duhet të regjistrohet në emër të Republikës së Kosovës dhe pastaj Qeveria do të bartë të drejtën e shfrytëzimit të saj tek investitori i huaj.

Neni 21

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjes Publike, pronës komunale dhe pronës të Agjencisë Pyjore të Kosovës tek Subjekti Investues

21.1 Qeveria mund të bartëtë drejtën e shfrytëzimit të pronës ndërmarrjeve publike, komunale dhe pronës të Agjencisë Pyjore të Kosovës tek Subjekti Investues për qëllim të zbatimit të ndonjë projekti për Investimet Strategjike,

22.2 Mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të pronës të ndërmarrjeve publike, komunale dhe pronës së Agjencisë Pyjore të Kosovës, për zhvillimin dhe realizimin e projekteve Investuese Strategjike, do të rregullohet me akte nënligjore.

Neni 22

Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës së Republikës së Kosovës nga ana e Subjektit Investues

22.1. Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës në të cilën janë bërë investimet e strategjike përcaktohet me marrëveshjen për investime duke marrë parasysh kohëzgjatjen maksimale të lejuar me këtë ligj, por kjo e drejtë nuk zgjat më shumë se 40 (katërdhjetë e) vite.

22.2. Autoriteti publik përgjegjës ka për detyrë të japë pëlqimin për vazhdimin e së drejtës për shfrytëzimin e pronës dhe për periudhën tjetër prej (vitesh) vitesh, nëse në pronë në të cilën janë bërë investimet e kapitalit të huaj janë të ndërtuara objekte apo ndërtesa që janë duke ushfrutëzuar në mënyrë aktive për qëllime afariste.

Neni 23

Ndërprerja e të drejtës për shfrytëzimin e pronës së Republikës së Kosovës nga ana e autoritetit publik

23.1 Autoriteti publik mund t'ia ndërpres investitorit të huaj të drejtën e shfrytëzimit të pronës dhe të shkëpusë marrëveshjen për investime strategjike vetëm në rastet vijuese:

a. nëse subjektit Investues i ka ndërpreme arsye që investitori i huaj do të jetë në gjendje ose i gatshëm të përmbushë detyrimet e veta; ose

b. për arsye madhore e në interes publik, me kusht që investitorit të huaj t'i paguhet kompensimii paraparë në marrëveshjen mbi investimet strategjike apo në përputhje me Ligjin për Investimet e Huaja.

Neni 24

Shkëputja e marrëveshjes mbi investimet strategjikenga Subjekti Investues

24.1 Investitori i huaj mund ta shkëpusë marrëveshjen për investime strategjikevetëm në rastet vijuese:

a. në rast se autoriteti publik nuk përmbushë një detyrim thelbësor lidhur me kontratën për investime;

b. nëse investitori i huaj e ka të pamundshme të ushtrojë veprimtarinë ekonomikesi rezultat i një veprimi ose mosveprimi të autoritetit publik apo për shkak të ndryshimeve të cilat mund të ndodhin në ekonominë botërore si rezultat i të cilaveinvestitori i huaj nuk ka leverdi të vazhdojë aktivitetin e tij ekonomik në Kosovë.

Neni 25

Shkëputja e marrëveshjes mbi investime strategjikenë rastet tjera

Secila palë ka të drejtë ta shkëpusë marrëveshjen për investimestrategjikenëse përmbushja e detyrimit të saj bëhet e pamundur për arsye të fuqisë madhore. Po ashtu palët mund ta shkëpusin kontratën e investimit me marrëveshje.

Neni 26

Kompensimi pas shkëputjes së marrëveshjes për investime strategjike

Marrëveshja mbi investimet strategjikedo tëparasheh se si llogaritet kompensimi që i takon palës kontraktuese përkatëse në rast të një shkëputjeje të marrëveshjes, duke përfshirë në llogaritjen e kompensimit, sipas rrethanave, vlerën e punës së kryer sipas marrëveshjes për investime strategjike, shpenzimet ose humbjet që ka pësuar ndonjëra palë, përfshirë edhe fitimin e humbur.

Neni 27

Mekanizmi për zgjidhjen e kontesteve të investimeve

14.1 Kontestet mes autoritetit publik dhe njësubjektit Investues të huaj lidhur me përmbushjen dhe interpretimin e marrëveshjes për investime strategjike zgjidhen me anë të procedurave për zgjidhjen e kontesteve për të cilat janë pajtuar palët në marrëveshjen për investime strategjike.

14.2 Në qoftë se marrëveshja për investimet strategjike nuk i parasheh mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve të investimeve, atëherë këto konteste zgjidhen në bazë të Ligjit për Investimet e Huaja (Ligji Nr. 02/L-33).

14.3 Kontestet mes autoritetit publik dhe njësubjektit Investues vendas lidhur me përmbushjen dhe interpretimin e marrëveshjes për investime strategjike zgjidhen me anë të procedurave për zgjidhjen e kontesteve për të cilat janë pajtuar palët në marrëveshjen për investime strategjike.

14.4 Në qoftë se marrëveshja për investimet strategjike nuk i parasheh mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve të investimeve, atëherë këto konteste zgjidhen në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës.

Neni 28

Ligji i zbatueshëm për kontestet e Investimeve me subjekt investues të huaj

14.1 Gjykata ose Tribunali i arbitrazhit qëshqyrton një kontest të investimeve të paraparë me këtë ligjdo të vendosë për çështjet në kontest sipas rregullave thelbësore apo ligjeve të pajtuara me shkrim nga palët.

14.2. Në mungesë të një pajtimi të tillë, gjykata apo tribunali i arbitrazhit do të aplikojë ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, duke përjashtuar rregullat private të ligjeve ndërkombëtare dhe rregullat e tilla të ligjeve publike ndërkombëtare që mund të jenë të aplikueshme për çështjet kontestuese.

Neni 29

Përjashtimi i procedurës konkurruese për hyrje në marrëveshje mbi investimet strategjike

Marrëveshjet mbi investimetstrategjikelidhura në bazë të dispozitave të këtij ligji, nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit dhe tenderimit publik të parapara me ligjet e Kosovës.

Neni 30

Konflikti me aktet e tjera normative

23.1. Në rast të konfliktit ndërmjet dispozitave të këtij ligji me dispozitatkushtetuese tëRepublikës së Kosovës ose ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare të cilën Kosova është e detyruar ta respektojë, dispozitat kushtetuese ose marrëveshja në fjalë mbizotëron.

23.2. Në rast të konfliktit ndërmjet dispozitave të këtij ligji me dispozitat e ndonjë akti tjetër normativ të zbatueshëm në Kosovë, dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë.

31

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

24. 1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Komisionin për Investime Strategjike nxjerrë akte nënligjoretë nevojshme për shpjegimin dhe zbatimin e këtij ligji.

24.2 Të gjitha projektet për aktet nënligjore duhet t'i dorëzohen zyrës së Kryeministrit për shqyrtim dhe komentim. Zyra e Kryeministrit duhet të pranojë dhe të shqyrtojë të gjitha projektet për hartimin e aktevenënljgore.

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

